

Masat parambrojtëse:

• P102: Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa arritëshme nga fëmijët. • Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë. • P261: Shmangni thithjen e produktit me frymëmarrje. • P270: Mos hani, mos pini lëngje dhe duhan gjatë përdorimit të këtij produkti. • P280: Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze. • EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin ndiqni udhëzimet për përdorimin. • P362+P364: Hiqni rrobat e kontaminuara pas përfundimit të punës dhe lajini ato para ripërdorimit. • P501: Asgjësoni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloret kombëtare në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

• H335: Mund të shkaktojë iritim respirator. Në rast thithje: zhvendoseni të aksidentuarin në ajër të freskët dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Kërkoni ndihmë mjekësore. • H304: Mund të jetë fatale nëse gëlltitet dhe hyn në rrugët e frymëmarrjes. Në rast gëlltije: zhvendoseni të aksidentuarin në ajër të freskët dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Kërkoni ndihmë mjekësore. P331: Mos provokoni të vjella. • H315: Shkakton iritim të lëkurës. H317: Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës. P302+P352: Në rast kontakti me lëkurën (flokët): lahuni menjëherë me ujë të bollshëm dhe sapun. Kërkoni këshilla mjekësore nëse acarimi vazhdon pas larjes. • H319: Shkakton acarime të rënda të syve. P305+P351+P338: Në rast kontakti me sytë: lajini me ujë të bollshëm për disa minuta, hiqni lentet e kontaktit nëse është e nevojshme dhe e lehtë për t'u bërë. Vazhdoni shpëlarjen. • Nuk ka antidot specifik dhe terapia është simptomatike. P101: Nëse kërkohet këshilla mjekësore, atëhere tregoni etiketën e produktit mjekut.

Data e prodhimit:

Data e skadimit: printuar ne ambalazh

1 Lit.

NICOGAN

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

"Lexo fletudhëzuesin para përdorimit"

Lënda vepruese: 40 gr/lit Nicosulfuron

Formulimi: Vaj dispersiv (OD)

Nr. i regjistrimit: 707, dt. 08/05/2019



**HERBICID SELEKTIV SISTEMIK, I PAS
MBJELLJES (MBIRJES). PËRDORËT PËR
KONTROLLIN E BARËRAVE TË KËQIA NJË DHE
SHUMË VJEÇARE, GJETHE GJERA DHE
GJETHE NGUSHTA NË MISËR. KY HERBICID
THITHET NGA BIMA NËPËRMJET GJETHES
DHE SISTEMIT RRËNJOR DHE LËVIZ NË INDET
E RRRITJES TË BIMËS NË DREJTIM
AKROPETAL DHE BAZIPETAL (NGA KSILEMA
NË FLOEMË). PENGON SINTEZËN E
ACETOLAKTAZËS (ALS), BLOKON NDARJEN
QELIZORE DHE RRRITJEN E BARIT TË KEQ.**



Distributor:
MELDI Sh.p.k.
Tiranë - Shqipëri



Aplikant: ADAMA Agriculture B.V
Prodhuesi: ADAMA Agan Ltd

Përdorimi:

Përdoret në misër, për kontrollin e barërave të këqia graminore një dhe shumë vjeçare si dhe atyre gjethe gjera, me 1-1.5 lit/ha, në 200-400 lit ujë. Përdoret kur misri është në fazën 2-3 deri 5-8 gjethe dhe barërat e këqia gjethe gjera janë në fazën 2-4 gjethe, barërat e këqia graminore janë në 2 gjethe ndërsa ato që shtohen me rizoma janë 20-25 cm lartësi.

Kontrollon: - barërat gjethe gjera: Nena (*Amaranthus retroflexus*), laboti, trasta e çobanit, laboti i egër, tatulla, bamja e egër (*Hibiscus trionum*), hithëbuta e pupurtë (*Lamium purpureum*), neçja pjeshkore (*Persicaria maculosa*), dredhja e arave, vjollca e arave (*Vjollca arvensis*), gjethe delli (*Plantago major*), veronika persiane (*Veronika persica*), sinapi, *Solanum nigrum*, *Helianthus tuberosus*, kamomili, etj.;

- barërat gjethe ngushta: muhari (*Echinochloa crus-galli*), bisht dhelpra (*Setaria glauca*), meli i përgjakur (*Digitaria sanguinalis*), melkuqi me rizoma (*Sorghum halpense*), *Lolium spp*, *Avena spp*.

Ndikimi në ekosistem:

H400: Shumë toksik për gjallesat ujore. H410: Shumë toksik për gjallesat ujore, duke shkaktuar efekte afatgjata të dëmshme. Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos i pastroni paisjet e punës në afërsi të ujërave sipërfaqësore. Shmangni kontaminimin përmes sistemeve të kullimit të ujit nga fermat dhe rrugët. Për të mbrojtur organizmat ujore dhe bimët që nuk janë objekt i trajtimit, respektoni një rrip sigurimi prej 5 m të pa trajtuar nga kanalet e ujërave sipërfaqësore dhe nga zona e pa kultivuar.

Për të mbrojtur organizmat ujorë, mos aplikoni në zonat me një pjerrësi prej më shumë se 4%.

Karenca:

Nuk aplikohet.

Ruajtja dhe magazinimi:

Produkti ruhet në vend të thatë dhe të freskët. Temperatura e ruajtjes duhet të jetë 5-40° C.